



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 35 (827839)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 shtator 2023

Ekspertët kibernetikë të Institutit për Siguri në Qeverisje, bashkëpunim me MM dhe ASHSK

Mes sfidave të sotme në rritje të sigurisë kibernetike, Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë ndërmori një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes kibernetike, duke bashkëpunuar me Institutin për Siguri në Qeverisje në SHBA. Përgjatë një jave, ekspertë të sigurisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe organizata të tjera qeveritare të rëndësishme, përgjegjëse për sigurimin e qëndrueshmërisë kibernetike të rrjeteve dhe të dhënave të vendit, u bënë pjesë e aktivitetit të ekspertëve kibernetikë nga "Defense Security Cooperation University". Ky angazhim është i dyti në një seri dyvjeçare të

misioneve këshilluese jo rezidente për ndërtimin e kapaciteteve kibernetike me Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë. Ky seminar me fokus në zhvillimin e strategjisë kibernetike, i mundësoi Ministrisë së Mbrojtjes dhe zyrtarëve të tjerë kryesorë të qeverisë që të qartësojnë kuptimin e tyre të ndërsjellë të strategjive kibernetike kombëtare dhe të mbrojtjes si dhe të planifikojnë zbatimin e strategjisë dhe burimet që kanë. Seminari çoi në një mirëkuptim më të gjerë se si ministritë e tjera dhe organizatat kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes mund të komunikojnë dhe bashkëpunojnë ... >>> faqe 2



Ministri Peleshi: Përulem para sakrificës së çdo ushtaraku



>>> faqe 3

Gjeneralmajor Arben Kingji priti kryekapter Mark Morgan

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, priti në një takim pune kryekapterin Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF) dhe atasheun amerikan CDR Eric Cote. Tema e diskutimit ishte mbi zhvillimin e Konferencës së Nënoficerëve të Ushtrive Evropiane, që pritet të mbahet në vitin 2024 në Shqipëri, në drejtimin e USAREUR...



>>> Faqe 2

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile, BMEC e 'Heronjve të Heshtur' të FA-së

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC) në Komandën Mbështetëse, është struktura që siguron kapacitetet e nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake, të emergjencave civile, të kërkim - shpëtimit, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit. Kjo strukturë kryen detyra të rëndësishme në tërësinë e zhvillimit të aktivitetit të Komandës Mbështetëse. Baza e Mbështetjes të Emergjencave Civile (BMEC) përgatit dhe stërvit...



>>> Faqe 5

Shërbimi i Transportit në FA, forca lëvizëse e gatishmërisë së lartë operacionale

Transporti ushtarak është pjesë përbërëse e rëndësishme e shërbimit të mbështetjes logjistike, ku logjistika në vetvete përfshin lëvizjen, zinxhirët e furnizimit me sektorët përbërës të saj, si dhe mbështetjen e Forcave të Armatosura. Transporti Ushtarak është një nga elementët kryesorë të kësaj mbështetjeje. Historiku i shërbimit të transportit ushtarak, nis me fillimet e organizimit të transportit ushtarak shqiptar, që pas krijimit të ushtrisë pas vitit 1912 e më tej 1924-1927, por si datë historike, transporti ushtarak lidhet me krijimin e batalionit...



>>> Faqe 6

Gjeneralmajor Arben Kingji priti kryekapter Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, priti në një takim pune kryekapterin Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF) dhe atashen amerikan CDR Eric Cote.

Tema e diskutimit ishte mbi zhvillimin e Konferencës së Nënoficerëve të Ushtrive Evropiane, që pritet të mbahet në vitin 2024 në Shqipëri, në drejtimin e USAREUR-AF. Në këtë aktivitet të rëndësishëm do të diskutohen zhvillimet e reja në interes të trupës së nënoficerëve, në shkëmbimin e ideve, njohurive, eksperiencës, si dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të forta mes vendeve pjesëmarrëse në këtë konferencë.

Gjeneralmajor Kingji shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Komandën Amerikane për Evropën dhe



Afrikën, si dhe vlerësoi profesionalizmin dhe performancën e secilit ekip instruktor e trajnues, përgjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta me qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë së forcave tona.

Një ndër prioritetet e Forcave të Armatosura të RSH është zhvillimi, promovimi dhe fuqizimi i nënoficerëve në të gjitha formacionet ushtarake, me fokus të veçantë tek nënoficerët e rinj (komandant grupi dhe skuadre).

Që nga qershori i vitit 2022 është miratuar "Rregullorja e Nënoficerëve të FARSH", bazuar në dokumentet dhe udhëzimet e NATO-s dhe ushtrisë amerikane për zhvillimin e mëtejshëm të lidershit dhe pozitave të kësaj trupe.

Ekspertët kibernetikë të Institutit për Siguri në Qeverisje, bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjencitë Shqiptare për Sigurinë Kibernetike

Mes sfidave të sotme në rritje të sigurisë kibernetike, Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë ndër mori një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes kibernetike, duke bashkëpunuar me Institutin për Siguri në Qeverisje në SHBA. Përgjatë një jave, ekspertë të sigurisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe organizata të tjera qeveritare të rëndësishme, përgjegjëse për sigurimin e qëndrueshmërisë kibernetike të rrjeteve dhe të dhënave të vendit, u bënë pjesë e aktivitetit të ekspertëve kibernetikë nga "Defense Security Cooperation University". Ky angazhim është i dyti në një seri dyvjeçare të misioneve këshilluese jo rezidente për ndërtimin e kapaciteteve kibernetike me Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë.

Ky seminar me fokus në zhvillimin e strategjisë kibernetike, i mundësoi Ministrisë së Mbrojtjes dhe zyrtarëve të tjerë kryesorë të qeverisë që të qartësojnë kuptimin e tyre të ndërsjellë të strategjive kibernetike kombëtare dhe të mbrojtjes si dhe të planifikojnë zbatimin e strategjisë dhe burimet që kanë. Seminari çoi në një mirëkuptim më të gjerë se si ministritë e tjera dhe organizatat kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes mund të komunikojnë dhe bashkëpunojnë më mire në mbrojtjen e strukturës kibernetike të Shqipërisë.

Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes J-5/8, Shtabit të Përgjithshëm, Njësia Kibernetike Ushtarake (NJKU), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) morën pjesë në këtë seminar njëjavor të zhvillimit të strategjisë kibernetike. Ekspertët e Institutit për Siguri në Qeverisje zhvilluan ushtrime dhe diskutime që i çuan pjesëmarrësit të zhvillonin njohuri të reja dhe identifikuan hapa konkretë që mund të ndërmerren



për të përmirësuar pozicionin e sigurisë kibernetike të Shqipërisë. Ekspertët tanë morën praktikën dhe parimet më të mira të operacioneve kibernetike dhe i zbatuan ato në strategjitë, prioritetet e sigurisë dhe kontekstin e Shqipërisë. Seminari theksoi zhvillimin e planeve të veprimit për linjat prioritare të përpjekjeve që identifikojnë qëllimet dhe objektivat, si dhe detyrat specifike për të udhëhequr veprimet aktuale dhe të ardhshme dhe vendimarrjen në nivel ministror. Këto linja përpjekjesh do të

formojnë dhe informojnë vendimet në lidhje me buxhetimin kibernetik, blerjen, fuqinë punëtore dhe operacionet.

Ministrinë e Mbrojtjes do të mirëpresë një këshilltar nga ky institut, i cili do të mbështesë drejtpërdrejt Njësinë tonë Kibernetike Ushtarake, me këshilla dhe asistencë, ndërsa ajo rritet dhe zhvillon aftësitë e saj kibernetike. Këshilltari do të qëndrojë në Shqipëri për dy vjet dhe do të kontribuojë për këshillimin dhe edukimin jo rezident. Shqipëria po demonstroi

një angazhim të fortë për të zhvilluar aftësitë e saj të sigurisë kibernetike dhe duke kontribuar në përpjekjet e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara për të përforcuar normat e sjelljes së përgjegjshme të shtetit në hapësirën kibernetike.

Drejtuësi i Institutit për Siguri në Qeverisje, z. David Radcliffe, pohoi se "Shqipëria është një partner i rëndësishëm i Shteteve të Bashkuara dhe ne vazhdojmë të jemi të befusuar me energjinë dhe entuziazmin që kolegët

tanë në Shqipëri po i përkushtohen përmirësimit të aftësive të tyre në hapësirën kibernetike. Mezi presim të vazhdojmë të punojmë krah për krah me miqtë tanë shqiptarë për ndërtimin e kapaciteteve institucionale kibernetike."

Instituti do të vazhdojë të zhvillojë aktivitetet me Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë gjatë viteve të ardhshme mbi strategjinë dhe politikën kibernetike dhe të ndihmojë në zhvillimin e fuqisë punëtore kibernetike.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në vazhdimësi të situatave të zjarreve dhe reshjeve në vend, deklaroi se: “Mekanizmi Kombëtar i Mbrojtjes Civile ka funksionuar këtë vit më mirë se çdo herë tjetër, ku deri më tani janë mundur të menaxhohen me shumë sukses 465 vatra zjarri. Kur them sukses, e kam fjalën që kemi arritur objektivin primar të ruajtjes së jetës së njerëzve, pra nuk kemi asnjë jetë të humbur, madje as të rrezikuar. Nga ana tjetër kemi ruajtur gjithashtu pasurinë e qytetarëve tanë në qytet apo në fshat. Kemi ruajtur dhe kemi shmangur më të keqen në shumë zona pyjore. Përgjithësisht zonat e djegura nga këto zjarre kanë qenë kullota. Kemi shmangur zjarret në pemëtari, pra kemi ruajtur pasurinë e qytetarëve”, - theksoi ministri.

Ministri Peleshi u shpreh se: “Problematikat e shkaktuara nga zjarret në qarqet Fier, Vlorë dhe Dibër, duke filluar nga zonat e Frakullit në Fier, ku filloi edhe sezoni i zjarreve, kemi pasur situatë të vështirë aty, që me vështirësi, por me shumë seriozitet, me angazhim dhe bashkëpunim u arrit të shmanget. Zjarr kritik ka qenë zjarri mbi Porto Palermo, pranë Qeparoit, gjithashtu pranë zonave të banuara, në një zonë turistike, në pikun e sezonit, u menaxhua në një kohë shumë të shpejtë”. Më tej ministri u ndal edhe në zjarrin e Shpiragut, ku falë një bashkëpunimi të jashtëzakonshëm është arritur shuarja përfundimtare, duke ditur rëndësinë që ka Shpiragu për shkak dhe të kantierit aty afër.

“Kanë filluar dhe shenjat e para të trokitjes së sezonit të reshjeve. Ka pasur reshje në veri, mund të ketë situata lokale dhe në orët në vijim ndonjë dalje nga shtrati e ndonjë për-



Ministri Peleshi: Përulem para sakrificës së çdo ushtaraku

roi, ndonjë përmytje lokale, të cilat sado të vogla mund të shkaktojnë rreziqe deri në humbje jete nëse nuk tregohemi të kujdesshëm. U bëj thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë për çdo situatë emergjente, bashkive, që janë përgjegjëset kryesore për të përballuar

emergjencat. Prefektët kanë bërë punë të jashtëzakonshme. Do na duhet ta mbajmë tempin dhe kjo është arsyeja pse gjykova të dal në komunikim”, - u shpreh z. Peleshi. Referuar shirave, të cilat përfshinë vendin gjatë këtyre ditëve, ministri u bëri thirrje qytetarëve

dhe bashkive që të qëndrojnë vigjilentë dhe të bashkëpunojnë për çdo situatë emergjente, përmytje apo rrëshqitje dherash. Ministri shtoi se Forcat e Armatosura kanë qenë faktor kyç në çdo situatë apo moment kritik. “Dua t’i falënderoj, pasi janë në çdo situatë,

në çdo moment kritik, duke sakrifikuar, duke rrezikuar. Kemi mundur të mbrojmë jetën e qytetarëve dhe të mbajmë ushtarakët të pa kërcënuar. Përulem para sakrificës së çdo ushtaraku. Janë të pa zhurmshëm, por bëjnë punë të madhe”, - përfundoi ministri Peleshi.



KM zhvilloi takimin mbi “Kërkesat buxhetore për Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026, Faza II”

Komanda Mbështetëse, si struktura përgjegjëse për programin “Mbështetja e Luftimit” organizoi një takim, ku morën pjesë komandantët e reparteve, shefat e financës së strukturave buxhetore si njësi shpenzuese të përfshira në këtë program.

Qëllimi i këtij takimi është përpunimi i detyrave teknike të buxhetit brenda limiteve përfundimtare të miratuara. Komandanti i KM-së, gjeneral brigade Ferdinant Dimo në fjalën e tij theksoi rëndësinë e takimit, ku veçoi se: “Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për mbështetjen me shërbime të trupave të luftimit, të trupave të mbështetjes së luftimit si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare është thelbi i këtij programi dhe, për këtë, duhet një planifikim i detajuar dhe real i buxhetit, duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi si dhe kushtet reale të Forcave tona të Armatosura.”

Më tej takimi vazhdoi me analizimin e detyrave teknike mbështetur në produktet e këtij programi si: burimet njerëzore, mallrat e shërbimet që kryejnë mbështetjen logjistike në FA, për fazën e dytë të PBA-së për vitet 2024-2026.



Anija P-134 “Butrinti” zhvillon stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Frankfurt A1412”

Anija P-134 “Butrinti” pjesë e misionit të NATO-s në detin Egje, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Frankfurt A1412” në ujërat ndërkombëtare.

Gjatë stërvitjes në bordin e anijes P-134, zhvilloi një vizitë dhe komandanti i grupit detar të aktivitetit të NATO-s në detin Egje, kapiten i rangut I Mathesius. Gjatë vizitës u dhanë udhëzime në lidhje me ecurinë e misionit, fluksin e emigrantëve në zonën tonë të përgjegjesisë, taktikat e përdorimit të emigrantëve për kalimin e kufirit, si dhe monitorimin e rajonit dhe raportimin te anija flamurtare.

Në një periudhë të shkurtër kohore, për më pak se dy muaj pjesëmarrje në mision, anija Butrinti i ka ardhur në ndihmë 180 personave, të cilët ndodheshin në rrezik për jetën.



NJOFTIM:

VIJOJNË REGJISTRIMET NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA.

Të dashur maturantë/e, regjistrimet për fituesit e raundit të parë në programet e studimit Bachelor kanë filluar, më datë 29 gusht, dhe do vijojnë deri më 11 shtator, nga ora 8.00 deri në orën 16.00.

Ju rikujtojmë se nesër është dita e fundit e fazës (1) parë 48-orëshe.

Procesi i regjistrimit është i ndarë në 7 faza 48-orëshe.

Procesi i regjistrimit zhvillohet pranë Sekretarisë Mësimore, në Akademinë e Forcave të Armatosura, Tiranë.

Rikujtojmë maturantët që të tregohen të kujdesshëm me zbatimin e afateve të regjistrimit.

Në rastin e mosregjistrimit brenda 48 orëve, ju e humbisni të drejtën e regjistrimit në programin ku jeni përzgjedhur.

Dokumentet që duhet të paraqiten, siç ju kemi bërë me dije më parë në njoftimin e mëparshëm, janë:

- ✓ Vërtetim nga gjykata;
- ✓ Vërtetim nga prokuroria;
- ✓ Vërtetim nga zyra përmbarimore;
- ✓ Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- ✓ Procesi ka tarifën për regjistrim në vlerën 2000 lekë.

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile, BMEC e 'Heronjve të Heshtur' të FA-së

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC) në Komandën Mbështetëse, është struktura që siguron kapacitetet e nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake, të emergjencave civile, të kërkim - shpëtimit, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit.

Kjo strukturë kryen detyra të rëndësishme në tërësinë e zhvillimit të aktivitetit të Komandës Mbështetëse. Baza e Mbështetjes të Emergjencave Civile (BMEC) përgatit dhe stërvit personelin në interes të detyrimeve që kërkon misioni i BMEC. Ajo ka për detyrë aftësimin e personelit për tu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit.

Kryerja e operacioneve të kërkim - shpëtimit në kohë paqe, krize dhe lufte për njerëzit dhe mjetet në rrezik është një detyrë tjetër e BMEC-së. Bashkëveprimi me strukturat e OJQ-ve Kombëtare dhe ndërkombëtare në raste krizash dhe emergjencash civile, eliminimi i pasojave të shkaktuara nga tërmetet, zjarret, përmblytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore e të veprimit njerëzor, janë detyra gjithashtu të Bazës të Mbështetjes të Emergjencave Civile, përgatitja e forcave për ndërhyrje në vatrat e dëmtuara dhe lehtësimi i pasojave të shkaktuara në këto fatkeqësi, si dhe dhënia e ndihmës, vendeve të rajonit në rast EC, në kuadrin e NATO-s.

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile në Komandën Mbështetëse është struktura që operon ngushtësisht me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile, struktura të tjera të FA-së dhe gjendet pranë popullatës në çdo rast fatkeqësie.

Fusha e Mbrojtjes Civile në Shqipëri është relativisht e re dhe në të shkuarën kryesisht ka shërbyer si një strukturë ushtarake. Megjithatë edhe më herët ka pasur problematika të ndryshme dhe personel që merreshin me mbrojtjen civile, por mbështetja mbi baza ligjore, e këtij shërbimi për herë të parë është formalizuar me dekret të Kuvendit Popullor Nr. 3924, dt. 07.12.1964, i cili e vendoste Shërbimin e Mbrojtjes Civile, në varësi të Ministrisë së Brendshme. Më vonë, drejtimi në nivel qendror i këtij shërbimi kaloi në Këshillin e Ministrave e më pas në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në Ministrinë e Brendshme dhe në vitet e fundit, Mbrojtja Civile në Shqipëri është rinovuar në koncept, strukturë dhe detyra, duke u përfunduar me strukturat e vendeve të tjera në funksion të planifikimit, koordinimit dhe menaxhimit sa më të mirë të emergjencave civile. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është pjesë përbërëse e strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Baza e Mbështetjes të Emergjencave Civile (BMEC) në Komandën Mbështetëse është struktura që siguron kapacitetet e nevojshme operacionale.

Kriza e vitit 1998-1999, e luftës në Kosovë shërbeu si një shembull, ku u ndërthurën shumë faktorë, përfshirë edhe planifikimin e emergjencave, mbrojtjen civile dhe menaxhimin e krizës. Siguria e qytetarëve, e pronës, e mjedisit dhe e vlerave kulturore merr rëndësi të veçantë edhe për shkak të kërcënimeve të rreziqeve, që janë rezultat i prodhimit, përdorimit dhe ruajtjes së materialeve të rrezikshme, si dhe aktiviteteve kriminale e terroriste, që mund të kërcënojnë jetën e komunitetit. Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1, 170 dhe 174 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat Civile". Ky është ligji i parë në historinë e legjislacionit shqiptar, i përmbledhur dhe i pavarur në këtë fushë. Gjatë viteve të fundit janë bërë përpertime në kompletimin e bazës ligjore, planifikimit në të gjitha nivelet, ngritjes së strukturave si dhe ngritjes tekniko-profesionale të personelit të Shërbimit të Emergjencave.

Përballja me sukses e çdo situatë, angazhim në EC për shuarjen e zjarreve

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit në Shqipëri zjarret, sidomos në pyje, janë shtuar si numër por gjithashtu është rritur edhe përmasa e sipërfaqeve të prekura. Të dy treguesit janë mbi karakteristikat mesatare të vendeve mesdhetare. Që nga viti 1992 në Shqipëri është rritur ndjeshëm rreziku i zjarreve në pyje, duke arritur kulmin në vitin 2000. Vetëm dhjetëvjeçarin 1990-2000, raportoi ndërmyjet sipërfaqe pyjore të djegur dhe sipërfaqe së vendit ishte rreth 2.19. Zjarret në pyje dhe kullota shpesh janë ngjarje që shkaktojnë shkatërrim në një zonë të



gjerë. Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, aksidentet dhe vënie të qëllimshme të zjarrit, djegia për kullota, si dhe shkaqet natyrore, rrufetë. Zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllim pastrim kullotash, vijnë të ndodhin çdo vit në vendin tonë, duke qenë më të dendur në pyje dhe gjeografikisht më tepër në jug të vendit. Rreziku më i madh i zjarreve në pyje është evident në fund të pranverës dhe gjatë periudhave të thata të verës. Një rol të rëndësishëm në menaxhimin e zjarreve, parandalimin apo shuarjen e tyre, ka bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës midis institucioneve shtetërore në nivel qendror, rajonal dhe lokal dhe i aktorëve të tjerë si përdorues, pronarë dhe subjekte private, duke bërë që këto

viteve të fundit. Por edhe këtu, "faktorin njeri" cilësohet po aq i dëmshëm dhe me efekte direkt në shkaktimin dhe favorizimin e zjarreve. Sipas një tradite të vjetër bujqësore tokës i vihet flaka për ta përgatitur për sezonin e ardhshëm. Por në shumë raste, si pasojë e erërave të forta, afërsisht me pyjet, thatësi dhe ajrit të nxehtë, zjarret avancojnë me shpejtësi dhe shkaktojnë djegie masive të pyjeve. Një shkak tjetër është dhe logjika krejtësisht tregtare që përdorin pronarët apo përdoruesit e pyjeve, të cilët djegin drurët tradicionalë pa ndonjë vlerë të madhe në treg për t'i zëvendësuar ato më vonë me drurë të tjerë me "vlerë tregtare" si eukaliptet, palmat, etj. Sipas disa vlerësimeve, gjatë periudhës 2000-2003, zjarret në Azinë Juglindore shkaktojnë një dëm prej 16-18 miliardë dollarësh. Por Mesdheu është një

dhe vlerësimeve të ekspertëve, në ndryshim nga shumë rajone të tjera të botës ku faktorët me origjinë natyrale janë më prezentë se sa në rajonin e Mesdheut. Vendet europiane shpenzojnë çdo vit me miliarda euro në luftën kundër zjarreve të pyjeve dhe miliarda euro të tjera si subvencione e programe speciale pyllëzimi. Tashmë në shumicën e vendeve mesdhetare është ndërtuar linja kryesore e politikave, ku të investosh masivisht dhe me koncepte e praktika të qarta në parandalimin e zjarreve në pyje, do të thotë jo vetëm të eliminosh zjarret, por dhe të zvogëlosh shumë koston e përballimit të përhapjes dhe shuarjes së tyre.

Angazhimi i forcave dhe mjeteve në situata të shkaktuara nga përmblytjet, tërmetet dhe emergjenca të tjera

Kushtet e këqija atmosferike, nga reshjet e dendura të shiut nuk i kanë ndalur efektivet e Bazës së Mbështetjes të Emergjencave Civile të Komandës Mbështetëse të realizojnë me sukses misionet e tyre të kërkim-shpëtimit në ndihmë të komunitetit. Si ditën ashtu edhe në orët e vona të natës, i kemi parë ata mbi gomone dhe pranë motor-pompave, duke ndihmuar dhe transportuar banorë, kur shirat e dendur kanë përmblytur shtëpi banimi e biznese të ndryshme, duke bllokuar qindra persona në ambiente të ndryshme. Me ndihmën e grupit të palombarëve shpesh është bërë i mundur kërkimi në brendësi të objekteve të përmblytura si dhe shpëputja e energjisë elektrike me qëllim evitimin e ndonjë incidenti të mundshëm. Të veshur me kostumin e tyre të palombarit, ky grup i mirë trajnuar shpesh ka evakuuar banorët nga zonat e përmblytura drejt zonave më të sigurta. Madje situata të tilla i kanë mbajtur ata jo rrallë herë të angazhuar përgjatë gjithë natës deri në orët e para të mëngjesit. Qindra



situata të mundshme gjatë stinës së verës të përballohen me sukses.

Vetëm para pak ditësh, kur informoi publikun për situatën e zjarreve dhe reshjeve në vend, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi se Mekanizmi Kombëtar i Mbrojtjes Civile ka funksionuar këtë vit më mirë se çdo herë tjetër, ku deri më tani, tha ministri, janë mundur të menaxhohen me shumë sukses 465 vatra zjarri, duke ruajtur jetën e njerëzve, pa patur asnjë jetë të humbur dhe as të rrezikuar, si dhe duke ruajtur gjithashtu pasurinë e qytetarëve si në qytet ashtu edhe në fshat. Forcat e Armatosura të BMEC-së kanë qenë në luftë me flakët për të ruajtur dhe shmangur zjarret në shumë zona pyjore e pemëtari.

Parandalimi i zjarreve në pyje zvogëlon koston e përballimit të përhapjes dhe shuarjen e tyre

Në radhë të parë, si shkak i zjarreve evidentohen faktorët klimatikë, konkretisht thatësira e jashtëzakonshme, e cilësuar si më e madhja e 50

nga zonat më problematike të planetit. Në vendet mesdhetare numërohen mbi 60 000 zjarre në vit, bile në disa vende të evidentuara si më të vështirat në këtë aspekt, regjistrohen 20 000 deri 25 000 vatra zjarri në vit. Sipas Komisionit Europian "këto zjarre shkaktojnë çdo vit, kryesisht në sezonin e verës, mbi 700 000 hektarë pyje me një tendencë që vjen në zgjerim", duke u bërë kështu faktori kryesor i rrezikut ekologjik për këtë rajon.

Spanja, Portugalia, Greqia dhe Shqipëria, kanë njohur vitet e fundit thatësi më të madhe të tyre, të paktën për shekullin e fundit. Tashmë temperaturat 38, 40, madje edhe 45 gradë janë bërë normale në vendet e Mesdheut Verior e Jugor, por sipas Këshillit të Europës, "më shumë se sa thatësira, shkak kryesor i zjarreve është neglizhenca humane, piromanët si dhe barinjët apo fermerët që praktikojnë zjarret për të përfutur kullota apo përmirësuar cilësitë e tokës, vetëm 10-15 e zjarreve ndodhin për shkaqe natyrore e klimatike, ndërsa 85 % e tyre janë rezultat i veprimtarisë së njeriut". Kjo sipas statistikave

persona, bagëti e orendi të ndryshme kanë shpëtuar falë profesionalizmit dhe përkushtimit të këtyre heronjve të heshtur në këto operacione EC.

As uji, zjarri apo tërmeti nuk i ka ndalur efektivet e Bazës së Mbështetjes të Emergjencave Civile të Komandës Mbështetëse, në përballjen me situatat kritike për banorët e zonave në rrezik, siç ishte edhe rasti i tërmetit në Shqipëri i 26 nëntorit 2019. Mjetet e Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC) të Komandës Mbështetëse iu janë bashkëngjitur gjithashtu edhe nismave të bashkive në vend për pastrimin e ambienteve në zonat turistike si në Velipojë dhe Shirokë, në verën e këtij viti, etj., ku puna e trupave të FA-së në këtë operacion konsiston në grumbullim e transportim mbetjesh e inertesh të ndryshme. Ose më herët kur pas emergjencës të shpallur për pastrimin e Liqenit të Fierzës në Qarkun e Kukësit, më 2014, kur u kërkua bashkëpunimi me Brigadën e Mbështetjes Rajonale, (paraardhës i BMEC në atë kohë), ku u rastuan rreth 2300 m² sipërfaqe në breg të liqenit dhe u grumbulluan dhe transportuan rreth 90 metër kub mbetje plastike.

Shërbimi i Transportit në FA, forca lëvizëse e gatishmërisë së lartë operacionale

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Transporti ushtarak është pjesë përbërëse e rëndësishme e shërbimit të mbështetjes logjistike, ku logjistika në vetvete përfshin lëvizjen, zinxhirët e furnizimit me sektorët përbërës të saj, si dhe mbështetjen e Forcave të Armatosura. Transporti Ushtarak është një nga elementët kryesorë të kësaj mbështetjeje.

Historiku i shërbimit të transportit ushtarak, nis me fillimet e organizimit të transportit ushtarak shqiptar, që pas krijimit të ushtrisë pas vitit 1912 e më tej 1924-1927, por si datë historike, transporti ushtarak lidhet me krijimin e batalionit të parë të transportit, më 13 prill 1945. Në maj 1945 e në vazhdim u krijua batalioni i dytë i transportit. Pas një procesi ristrukturimi që zgjati afërsisht 40 vjet, në 1983 u krijua regjimenti i transportit. Si pasojë e faktit që specialiteti i transportit ishte bërë një nga kompetentët kryesorë të Forcave të Armatosura shqiptare, në vitin 1993 për herë të parë u krijua Brigada e Transportit. Që nga viti 2007 deri më sot, trupat e transportit janë të organizuara në nivel batalioni.

Batalioni i Transportit është komandimi, kontrolli, trajnimi dhe mirëmbajtja e një niveli të lartë gatishmërie dhe operacionale. Ai siguron transport të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të FA-së, në ndihmë të komunitetit e në të gjithë spektrin e operacioneve.

Në drejtimin e Batalionit të Transportit në Komandën Mbështetëse të FA-së, është nënkolonel Durim Islami, të cilin po e sjellim në faqet e shtypit ushtarak nëpërmjet kësaj interviste.

Shërbimi i Transportit Ushtarak, në rrugëtimin e tij historik

Më 22 prill 1913, doli “Rregullorja për organizimin e Ministrisë së Luftës”. Më 4 maj 1913, u formua Shtabi Madhuer (Shtabi Madhor). Më 6 maj 1913, formohet shërbimi i parë i prapavijës (i intendencës dhe i transportit). Më 1 shtator 1925, doli “Rregullorja mbi Përdorimin dhe mbajtjen e Automobilave.” Më 1 nëntor 1926, formohet Batalioni “Vjosa” në Shkodër, i kompletuar me 70 kafshë transporti. Shtator 1926, u ngrit një oficinë e mirëmbajtjes



Nënkolonel Durim Islami, komandant i Batalionit të Transportit në Komandën Mbështetëse të FA-së

së automjeteve të transportit ushtarak. Më 24 shtator 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, mori urdhra për krijimin e seksionit të transportit pranë shtabit të Korparmatës së I, ku theksohej: “Seksioni i transporteve dhe

i komunikacioneve kryen të gjitha punët që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe me rregullimin e trafikut dhe të komunikacioneve të trafikut, të transporteve ushtarake, materialin ushtarak, ushqimin dhe pajisjen, transportin e të plagosurve

dhe të sëmurëve, lidhjet (telefon, telegraf, postë), punimet teknike për qëllime ushtarake dhe organizimin e oficinave”. Po në këtë datë kanë dalë urdhra të tjerë që përcaktojnë strukturën, detyrat si dhe bashkërendimet me seksionet e tjera ushtarake, të seksionit të transportit, i cili në këto dokumente merr formën e plotë të organizimit të tij pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe në të gjitha njësitet e repartit e tjera të Ushtrisë. Shefi i parë i këtij seksioni u caktua Thanas Gjoka, i ardhur nga rreshtat partizane. Formohet kështu shërbimi i transportit automobilistik, i cili do të përballoste detyrat e luftës deri në çlirim e plotë të Shqipërisë dhe do të mbante mbi vete peshën kryesore të periudhës së luftës. Batalioni i Parë i Autotransportit në Tiranë, do të formohej me automjetet e rekuizuara në të gjitha qytetet e qarqet e Shqipërisë, në bazë të urdhrin nr. 11, rez., datë 07.04.1945, Batalioni i Dytë i Transportit në Durrës, i krijuar në javën e parë të muajit maj 1945.

Komandant Durim Islami, shërbimi i Transportit Ushtarak është tregues i rëndësishëm logjistik dhe i nivelit të infrastrukturës ushtarake. Batalioni i Transportit që ju drejtoni, çfarë roli luan në FA?

Batalioni i Transportit mbështet me Transport Komandën Mbështetëse dhe Strukturat e FA-së, në kohë paqe, krize dhe lufte, si dhe sigurimin e transportit të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit. Pra misioni i Batalionit të Transportit është komandimi, kontrolli, trajnimi dhe mirëmbajtja e një niveli të lartë gatishmërie dhe operacionale. Siç e thashë siguron transport të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të FA-së, por edhe në ndihmë të komunitetit e në të gjithë spektrin e operacioneve.

Misioni i Batalionit tonë të Transportit realizohet brenda misionit të Komandës së Mbështetjes, i organizuar si një hallkë e rëndësishme e zinxhirit logjistik me pajisjet dhe teknikën e mjeteve të transportit të kohës, në përshtatje me kushtet dhe nivelin teknologjik ku vepron, mbështetur në përvojën më të mirë të shkuar teorike e teknike, kombëtare dhe të vendeve të Aleancës të NATO-s.

Cilat janë detyrat që ka Batalioni i Transportit? Si realizohet mbështetja me transport në strukturat e FA-së?

Detyrat tona, pra të Batalionit të Transportit në Komandën e Mbështetjes, burojnë nga misioni ynë, që lidhet gjithçka me lëvizjen e mjeteve që ne disponojmë. Ne kryejmë një sërë detyrash të rëndësishme në FA. Batalioni i Transportit ka detyrë të transportojë personelin, pajisjet, kontejnerët dhe ngarkesat në mbështetje të operacioneve të Forcave të Armatosura. Të sigurojë kapacitete transporti për personelin dhe pajisjet, për një Batalion Këmbësorie njëherësh të Forcës Tokësore. Ka detyrë të komandojë, kontrollojë, pajisë, trajnojë dhe të mbajë një nivel





të lartë të gatishmërisë operacionale për batalionin. Administrojnë dhe mirëmban infrastrukturën, pajisjet dhe teknikën.

Por gjithashtu Batalioni i Transportit ka për detyrë të transportojë, ngarkojë dhe shkarkojë kontejnerë ISO në mbështetje të Operacioneve të Forcave të Armatosura të RSH. Të Transportojë ngarkimin-shkarkimin e pajisjeve kontejnerëve dhe ngarkesave në porte detare dhe aeroporte, kur kemi transport ajror. Por ne kryejmë edhe detyrën e mbështetjes me transport të strukturave të Forcave të Armatosura për përballimin e operacioneve të emergjencave, krizave, fatkeqësive natyrore, ndihmave humanitare dhe operacioneve paqeruajtëse. Kemi detyrë të mirëmbajmë dhe administrojmë infrastrukturën, pajisjet dhe teknikën ushtarake. Batalioni i Transportit ka detyrë të sigurojë mbështetjen me transport për të gjitha klasat e furnizimit (5 Kl.) të strukturave të FA-së, sipas nevojave me miratim të strukturave eprore.

Batalioni ynë merr pjesë në stërvitje të përbashkëta me qëllim realizimin dhe mbështetjen me transport sipas standardeve të NATO-s. Përpunimin e të gjithë procedurave të duhura përfshirë ato ekonomike, infrastrukturës dhe resurseve ushtarake e civile të transportit, për t'iu përgjigjur në kohë situatave të kohës paqes, krizës dhe konfliktit. I gjithë aktiviteti ynë operacional zhvillohet mbi zbatimin e të gjitha kritereve, procedurave për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e mjeteve.

Komandant, kur daton krijimi i Batalionit të Shërbimit të Transportit Ushtarak shqiptar?

Shërbimi i transportit ushtarak zë një vend të posaçëm në historinë e shërbimit të mbështetjes logjistike në Forcat e Armatosura dhe ai është sa rëndësishëm po aq edhe jetik. Transporti ushtarak është një bashkudhëtar aktiv, që shoqëron Forcat e Armatosura dhe Ushtrinë Shqiptare që nga krijimi i tyre. Shërbimi i Transportit ushtarak shqiptar dhe formacionet transportuese të tij kanë evoluar së bashku me transformimin shekullor të Forcave të Armatosura dhe ushtrisë shqiptare. Në fillimet e organizimit të transportit ushtarak shqiptar, në vitet 1912-1924-1927, faktet historike nxjerrin në dukje një përvojë të pakët organizuese e transportuese në strukturat drejtuese dhe në formacionet ushtarake fillestare, të krijuara me lindjen e shtetit të parë të pavarur shqiptar, si dhe në procesin e organizimit të ushtrisë.

Por më tej po ju sjell faktin kur Komanda e Prapavijave, me anën e Qarkores me Nr.484, datë 13 prill 1945, konfirmonte formimin e batalionit të parë të transport-komunikacionit civil, i cili hodhi bazat dhe hapin e parë në fillimin historik të organizimit dhe të aktivitetit të shërbimit me transport ushtarak. Në maj 1945, në Durrës u

krijua batalioni i dytë i transportit. Dhe në vitin 1980, në Pezë Helmës, u krijua Batalioni Operativ për transport Trupash.

Afërsisht 40 vjet pas themelimit në vitin 1983, në strukturën e re të FA-së u krijua Regjimenti i Transportit, i cili përbëhej nga Batalioni i Transportit të trupave, Batalioni i Riparimit,



Sektori i Teknikës Rezervë, Parku i Veturave të MM.

Në vitin 1993 u krijua Brigada e Transportit në vartësi të KML dhe në korrik 2001 u riorganizua Brigada e Transportit në vartësi të KML. Kurse në mars 2007, në kuadër të ristrukturimit, u kalua nga Brigadë Transporti në Batalion Transporti në vartësi të BrL dhe prej atij viti deri më sot është në vartësi të Komandës Mbështetëse me vendndodhje në Pezë Helmës.

Si është sot shërbimi i mbështetjes me transport i FA-së?

Më vjen mirë të them që Batalioni i Transportit, qëndron në pararojë të shërbimit të mbështetjes me transport të FA-së, si reparti më i madh e i specializuar, me përvojë transportuese në fuqi, kapacitet dhe në organizimin operacional transportues ushtarak.

Në këto 78 vite të krijimit të tij, batalioni i transportit ka realizuar detyra të ndryshme. Në morinë e detyrave mjaft të rëndësishme dhe njëherësh me përgjegjësi të lartë për Transportin Ushtarak, ka qenë pjesëmarrja në paradat ushtarake, të cilën dua ta përmend, pasi në paradën e zhvilluar, më datë 04 dhjetor 2017, me rastin e 95-vjetorit të krijimit të FARSH-së, Batalioni i Transportit u vlerësua me medalje, me urdhër nr. 616 dt. 03.12.2017, “Për dhënie medalje të Rep. Usht. Nr. 4007” nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili i akordon Btr-së Medalje “Repart i Shquar”, me motivacionin: “Për arritje të shquara për mbështetje në transport në Forcat e Armatosura”. Ky është jo vetëm një vlerësim për ne, por edhe një krenari dhe përgjegjshmëri për më tej.

Ndër detyra të tjera ndër vite që na bëjnë krenarë, gjithashtu ka spikatur edhe mbështetja në transportimin e personelit, materialeve, të të shpërngulurve gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1998-1999.

Kurse në vitin 2007, batalioni ka marrë pjesë në “Projektin për asgjësimin e municioneve të rënda”, në bashkëpunim me kompaninë Amerikane SAIC, ku u transportuan dhe asgjësuan rreth 2772 ton municione dhe u reduktuan rreth 11 grup-depo.

Çfarë mjete disponon Batalioni i Transportit sot? A janë mjetet dhe teknika e tij sipas standardeve që kërkon koha?

Batalioni i transportit disponon mbi 100 mjete të tipave të ndryshëm, të cilat janë të ndara në kamionë të lehtë, të mesëm, të rëndë dhe mjete speciale. Këto mjete kryejnë shërbimin për Emergjencën Civile (EC), transport municioni në interes të ndërmarrjes “MEICO”, zhvendosje municioni për repartet e Komandës Mbështetëse, transport materialeve jashtë vendit, transport materialeve teknike etj. Mbështetja me transport për INSTAT, Mbështetja me transport e të III-ve, Transport skrapit.

Batalioni i Transportit ka kryer dhe kryen detyra në interes të Qendror e Pushtetit Vendor, për transportin dhe shpërndarjen e materialeve logjistike të KQZ-së në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë.

Megjithëse është teknikë e vjetër në vite, ajo ka përballuar me sukses mbështetjen me transport të mesëm e të rëndë të të gjitha strukturave ushtarake të FA-së në stërvitje të ndryshme, duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e ngarkuara nga MM, SHPFA, dhe komandanti i KM-së. Shpresojmë që në kuadrin e Modernizimit të FA-së, brenda viteve 2024-2025, të fillojë zëvendësimi i një pjese të kësaj teknike me teknikë të re, kamionë të mesëm, të rëndë dhe mjete speciale për përballimin e kërkesave në rritje të FA-së në kuadrin e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Për të ardhmen pritet modernizimi me ndihmën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Librat janë të mbushur me njohuri, japin mësim për jetën, të mësojnë për vështirësitë, dashurinë, frikën dhe gjithçka që është pjesë e jetës. Librat kanë qenë këtu me shekuj dhe përmbajnë njohuri për të kaluarën dhe kulturat tona.

Në ditët e sotme, rëndësia që njerëzit i japin leximit të një libri, po vjen duke u zvogëluar, kjo për shkak të harxhimit të kohës së tyre me veprimtari të tjera të cilat i konsiderojnë më zbatimëse, si për shembull, lundrimi në rrjete sociale, ose thjesht marrja me politikë ditore etj. Duke qenë se këto zakone po nguliten në kokën e tyre që në fëmijëri, në të ardhmen ata nuk do t'i kushtojnë kohë librit dhe kështu bota e librit për ta do mbetet gjithmonë diçka e panjohur ose më mirë të themi, një derë kryesore e pahapur në jetë.

Të lexuarit e një libri na ndihmon të njohim një botë më të madhe sesa ajo në të cilën jetojmë. Na stimulon të jetojmë më shumë se sa një jetë, duke na bërë të hedhim poshtë thënien: "Kemi vetëm një jetë për të jetuar".

Na bën të udhëtojmë në vende të ndryshme të botës. Na jep mundësinë të njohim njerëz të cilët kanë jetuar me të vërtetë ose thjesht kanë qenë pjesë e imagjinatës së një shkrimtari, na bën të njohim personalitete nga më të ndryshmet.

Duke na mundësuar kështu të mësojmë nga ata historinë e tyre, si kanë qenë, çfarë kanë bërë, si kanë jetuar, si ia kanë dalë mbanë etj. Duke lexuar ne përjetojmë eksperiencën nga më të ndryshmet. Por edhe pse fizikisht trupi ynë nuk i ndjen, truri ynë stimulohet të mësojë nga ato eksperiencë.

Libri shkruhet për të dëshmuar gjuhën si shtyllën kryesore të kulturës së një etnie, libri nuk shkruhet për t'u bërë mall tregtie apo për përfitime të segmenteve të caktuara, që librin e shohin vetëm si relik të tezgash!

A futen librat në "listën e shpenzimeve" për të rinjtë shqiptarë?

Të rinjtë që janë të apasionuar pas librit, mundohen të kursejnë sa më shumë për të blerë qoftë dhe një libër në muaj. Fatkeqësisht, shumica e të rinjve zgjedhin të shpenzojnë kohën e lirë në forma të tjera si p.sh. ngrënia e një dreke jashtë, pirja e një kafeje, dalja në darkë etj., dhe nuk fusin librin fare tek lista e tyre e shpenzimeve.

Librat janë miku më i mirë

Një nga arsyt kryesore që tregojnë rëndësinë e librave në jetën tonë është se librat veprojnë si miqtë tanë më të mirë. Miqtë janë një nga pjesët më të rëndësishme të jetës sonë. Ne nuk mund ta imagjinojmë jetën tonë pa shoqërinë e një mikut të mirë. Në mënyrë të ngjashme, një libër është si një mik i mirë që vazhdimisht na frymëzon të bëhemi versioni më i mirë i vetes. Librat e pasurojnë mendjen tonë me njohuri ashtu si një mik i mirë.


Librat ndriçojnë imagjinatën tonë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për të kuptuar rëndësinë e librave në jetën tonë është se librat janë një nga format më krijuese të artit. Çdo libër që lexojmë ka fuqinë për të na transformuar në një botë të ndryshme të mbushur me disa personazhe

të mahnitshëm. Librat mund të rrisin fuqinë e imagjinatës sonë dhe mund të veprojnë si një portë që hap dyert për një botë ëndrrash, larg realitetit. Imagjinata dhe krijimtaria juaj do të simulohen duke lexuar një libër të mirë imagjinar.

Librat i japin perspektivë botës rreth nesh

Një libër i mirë ka fuqinë të ndryshojë mënyrën se si ne mendojmë, flasim dhe analizojmë gjërat. Ka libra të shumtë të shkruar në disa zhanre dhe çdo libër vjen me këndvështrimin e tij unik.



"Një dhomë pa libra, si një trup pa shpirt"



Leximi na jep një avantazh të analizimit të mjediseve të ndryshme, gjë që e shtyn mendjen tonë të jetë vëzhgues. Librat ndihmojnë në zhvillimin e prezencës së mendjes dhe aftësive vëzhgues, duke ndriçuar kështu rëndësinë e librave në jetën tonë.

Librat rrisin vetëbesimin

Kur lexojmë një libër, mësojmë për betejet dhe vështirësitë e personazheve të ndryshëm. Ndonjëherë ne madje i lidhim ato situata me jetën tonë personale.

Të kuptuarit e situatave të personazheve të një libri dhe sesi ata i kapërcejnë periudhat dhe sfidat e vështira, ju jep kurajë dhe besim për t'u marrë me problemet tuaja. Gjithashtu, një person që lexon do të ketë gjithmonë më shumë njohuri për tema të ndryshme që do ta pajisin atë më mirë për situata sociale dhe për të zhvilluar biseda me grupe njerëzish.

Librat ndihmojnë të rriteni emocionalisht

Një arsye tjetër që reflekton mbi rëndësinë e librave në jetën tonë është se leximi i librave vjen me një gamë të gjerë përfitimesh mendore dhe fizike. Leximi zgjeron fjalorin dhe aftësi të komunikimit, të cila ndihmojnë të ndërveprojmë më mirë me njerëzit.

Leximi është një mënyrë efektive për të rritur kujtesën dhe për të përmirësuar fokusin. Leximi i librave na bën empatik, sepse kur angazhoheni me personazhe imagjinare dhe kuptojmë situatat e tyre, kjo lë një ndikim të fortë në aftësinë tonë për të empatizuar njerëzit. Të keni një qëndrim empatik ju ndihmon të rriteni në një person më të mirë.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

NATO ripohon përkushtimin ndaj partneritetit afatgjatë me Bosnje-Hercegovinën

Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Operacionet, Tom Goffus, përshëndeti zhvillimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të Aleancës me Bosnje-Hercegovinën gjatë një vizite në Sarajevë, më 29 dhe 30 gusht 2023. Z. Goffus u takua me përfaqësues të Bosnje-Hercegovinës dhe të komunitetit ndërkombëtar, përfshirë ministrin e Mbrojtjes, komandantin e Shtabit të NATO-s në Sarajevë, komandantin e Operacionit "Althea" të Bashkimit Evropian, përfaqësuesin e Lartë në Bosnje-Hercegovinë, përfaqësuesin Special të BE-së në Bosnje-Hercegovinë dhe ambasadorë të vendeve të NATO-s.

Goffus tha se: "Një Bosnje-Hercegovinë e qëndrueshme dhe e sigurt dhe një Ballkan Perëndimor paqësor janë me interes strategjik për Aleancën. Për shumë vite, NATO ka mbështetur Bosnje-Hercegovinën në zhvillimin e kapaciteteve të saj të mbrojtjes dhe sigurisë, duke përfshirë përpjekjet e selisë së NATO-s në Sarajevë. Forcat e Armatosura të Bosnje-Hercegovinës përfaqësojnë një shembull të suksesshëm të një institucioni multietnik", - tha ai. NATO mbështet fuqimisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnje-Hercegovinës, në përputhje me Marrëveshjen e Përgjithshme Kornizë për Paqe, dhe qëndron plotësisht e përkushtuar për të vazhduar partneritetin e saj me Bosnje-Hercegovinën. "NATO do të vazhdojë këtë punë të rëndësishme përmes një game të gjerë mjetes partneriteti, duke përfshirë Iniciativën e Mbrojtjes dhe Ndërtimit të Kapaciteteve, për të ndihmuar Bosnje-Hercegovinën të avancojë përpjekjet e saj për reforma dhe të forcojë qëndrueshmërinë e saj ndaj ndërhyrjeve malinjë, për të mirën e të gjithë qytetarëve të saj."

Ai shtoi se: "Ne inkurajojmë autoritetet e Bosnje-Hercegovinës që të përfitojnë plotësisht nga mbështetja e NATO-s për përpjekjet e saj për reforma dhe të paraqesin Programin e saj të Reformës 2023, pa paragjykuar një vendim përfundimtar për anëtarësimin në NATO. Ky është qëllimi i stabilitetit në Bosnje-Hercegovinë dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor."

"NATO mbështet plotësisht rolin e rëndësishëm të Operacionit "Althea" të udhëhequr nga BE-ja dhe është e përkushtuar të vazhdojë ta mbështesë atë përmes Marrëveshjeve të "Berlin Plus", - tha gjithashtu zoti Goffus.

Marrëdhëniet e NATO-s me Bosnje-Hercegovinën

NATO dhe Bosnje-Hercegovina ndjekin një program bashkëpunimi të gjerë dhe reciprokisht të dobishëm, i cili përfshin mbështetjen për reformat demokratike, institucionale, të sektorit të sigurisë dhe të mbrojtjes. Programi i Reformës, si korniza kryesore e bashkëpunimit, ndihmon në drejtimin e përpjekjeve reformuese të vendit ndërsa vazhdon të ndjekë rrugën e tij euroatlantike.

Aleanca ka qenë e angazhuar për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë në Bosnje-Hercegovinë që nga fillimi i viteve 1990, kur filloi të mbështesë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund konfliktit në Bosnje-Hercegovinë. Bosnje-Hercegovina iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në 2006 dhe u ftua t'i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit (MAP) në 2010. Pjesëmarrja në MAP nuk paragjykon asnjë vendim për anëtarësimin e ardhshëm. Në kuadër të Planit të Veprimit të Anëtarësimit, bashkëpunimi i vendit me NATO-n strukturohet përmes Programit të Reformës së Bosnje-Hercegovinës, i cili përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO ndaj këtyre përpjekjeve. Për të lehtësuar bashkëpunimin, Bosnje-Hercegovina ka një mision diplomatik në selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë, si dhe një zyrë ndërlidhëse në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në Mons, Belgjikë. NATO ka një seli në Sarajevë me misionin kryesor për të ndihmuar autoritetet e Bosnje-Hercegovinës me reformat dhe angazhimet e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë në lidhje me programin PfP, dhe misionin dytësor të ofrimit të mbështetjes logjistike dhe të tjera për Forcën e Bashkimit Evropian (EUFOR), në Bosnje-Hercegovinë. NATO i ofron mbështetje EUFOR operacionit "Althea" sipas Marrëveshjeve të "Berlin Plus".

Pas pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia, në vitin 2022 dhe mjedisit të ndryshuar të sigurisë në Evropë, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre. Në shkurt 2023, ministrat e Mbrojtjes Aleate miratuan një paketë të re për Ngritjen e Kapaciteteve Mbrojtëse për Bosnje-Hercegovinën, për forcimin e aftësive të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit.

Ecuria e marrëdhënieve të NATO-s me Bosnje-Hercegovinën

Pas luftës së viteve 1992-1995 në Bosnje-Hercegovinë, NATO luajti një rol kyç në zbatimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit, për më vendosjeve paqeruajtëse gjatë një periudhe nëntëvjeçare nga dhjetori 1995 deri në dhjetor 2004. Forca Implementuese e udhëhequr nga NATO (IFOR) u vendos në dhjetor 1995 për të zbatuar aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit dhe u zëvendësua një vit më vonë nga Forca e Stabilizimit e udhëhequr nga NATO (SFOR). SFOR-i ndihmoi për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe për të lehtësuar rindërtimin e vendit pas luftës. Në dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit iu dorëzua BE-së, i cili që atëherë po kryen operacionin e EUFOR-it "Althea" në Bosnje-Hercegovinë.

Bosnje-Hercegovina iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në vitin 2006. Më pas u ftua t'i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit (MAP) në vitin 2010, një program i NATO-s me këshilla, asistencë dhe mbështetje praktike të përshtatur për nevojat individuale të vendeve që dëshirojnë të bashkohen me Aleancën. Vendi duhet të vazhdojë të ndjekë reformat demokratike dhe të mbrojtjes për të përmbushur aspiratat e tij euroatlantike. Për



këtë qëllim, nën MAP, Bosnje-Hercegovina prezantoi Programin e saj të parë të Reformës në vitin 2019. Ky program përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO ndaj këtyre përpjekjeve. Në fillim të vitit 2021, Bosnje-Hercegovina themeloi Komisionin për Bashkëpunim me NATO-n, i cili koordinon zbatimin e aktivitetëve reformuese në kuadër të Programit të Reformës. Në ditën e pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë në vitin 2022, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre. Gjatë Samitit të NATO-s 2022 në Madrid, aleatët ranë dakord për një sërë masash shtesë politike dhe praktike për të mbështetur vendin në forcimin e qëndrueshmërisë së tij, duke përfshirë zhvillimin e një pakete të re për Ndërtimin e Kapaciteteve Mbrojtëse (DCB). Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s miratuan paketën e re të DCB-së për Bosnje dhe Hercegovinën në shkurt 2023.

Fushat kryesore ku NATO bashkëpunon me Bosnje-Hercegovinën

Bashkëpunimi i Bosnje-Hercegovinës me NATO-n është reciprokisht i dobishëm dhe përfshin: Ndërtimin e aftësive dhe ndërveprimit; Mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO, si dhe Bashkëpunimin më të gjerë.

Ndërtimi i aftësive dhe ndërveprimit: NATO mbështet zhvillimin e aftësive të sigurisë dhe të mbrojtjes në Bosnje-Hercegovinë përmes Iniciativës për Ndërtimin e Kapaciteteve të Mbrojtjes dhe të Sigurisë (DCB). Paketa DCB 2023 për Bosnje-Hercegovinën përfshin iniciativë në fusha të tilla si menaxhimi i krizave, mbrojtja kibernetike, evakuimi aero-mjekësor dhe administrimi i pasojave të incidenteve që përfshijnë substanca kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore (CBRN).

Bosnje-Hercegovina po punon për të zhvilluar forca të armatosura plotësisht profesionale, të cilat janë të ndërveprueshme me forcat e NATO-s dhe kanë staf nga vullnetarë që plotësojnë standarde të larta profesionale. Për këtë qëllim, vendi ka marrë pjesë në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të PfP (PARP) që nga maji 2007. Roli i PARP është të sigurojë një bazë të strukturuar për identifikimin e forcave dhe aftësive që mund të jenë në dispozicion të Aleancës për trajnime shumëkombëshe, ushtrime dhe operacione paqeruajtëse dhe menaxhuese të krizave. Ai shërben gjithashtu si mekanizmi kryesor i përdorur për të udhëhequr dhe matur përparimin e mbrojtjes dhe reformës ushtarake.

Në vitin 2022, si pjesë e programit të konceptit të vlerësimit dhe reagimit të aftësive operacionale (OCC E&F), i cili është krijuar për të vlerësuar nivelin e ndërveprueshmërisë së njësive partnere, Bosnje-Hercegovina certifikoi me sukses një grup batalioni të lehtë të këmbësorisë sipas standardeve të gatishmërisë luftarake të NATO-s. Bosnje-Hercegovina ka deklaruar një sërë forcash dhe asetesh si potencialisht të disponueshme për aktivitetet e PfP-së, duke përfshirë aftësitë inxhinierike (depozitimi i mjeteve shpërthyes) dhe pajisjet përkatëse.

Që nga viti 2014, nën Iniciativën e Ndërveprueshmërisë së Partneritetit, vendi ka marrë pjesë në Platformën e Ndërveprueshmërisë, e cila bashkon aleatët me partnerët të përzgjedhur që janë kontribuues aktivë në operacionet e NATO-s. Bosnje-Hercegovina është një pjesëmarrëse aktive në programin e përshtatur Ndërtimi i Integritetit (BI), i cili fokusohet në qeverisjen e mirë dhe përdorimin transparent dhe efektiv të burimeve të mbrojtjes. Qendra e Trajnimit për Operacionet e Mbështetjes së Paqes (PSOTC) e akredituar nga NATO, e vendit ofron trajnime ekspertësh mbi ndërtimin e integritetit dhe tema të tjera për NATO-n dhe vendet partnere.

Mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO: Që nga viti 2009, Bosnje-Hercegovina kontribuoi me oficerë në Forcën Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë (ISAF) të udhëhequr nga NATO në Afganistan, si pjesë e kontingjenteve daneze dhe gjermane, dhe gjithashtu kontribuoi në misionin e saj pasues të Mbështetjes së Vendosur (RSM).

Një bashkëpunim edhe më i gjerë: Në kuadrin e Programit të Shkencës për Paqe dhe Siguri (SPS), fushat kryesore për bashkëpunim me Bosnje-Hercegovinën përfshijnë teknologjinë e avancuar, zbulimin dhe pastrimin e minave dhe municioneve të pashpërthyer, mbrojtjen kibernetike, kundër-terrorizmin dhe aspektet njerëzore dhe sociale të sigurisë. Veçanërisht, shkencëtarët nga Bosnje-Hercegovina janë të përfshirë në një projekt kërkimor SPS që synon të rrisë sigurinë e komunikimeve duke përdorur teknologjinë kuantike në rrjetet 5G. Aktivitetet e përfunduara së fundmi që përfshijnë Bosnje-Hercegovinën përfshijnë zbatimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor të Sistemit të Komandës së Incidentit të gjeneratës tjetër (NICS), një softuer komandimi dhe kontrolli i bazuar në ueb që lehtëson bashkëpunimin në të gjitha nivelet e gatishmërisë, planifikimit, reagimit dhe rimëkëmbjes gjatë fatkeqësive natyrore dhe incidentet e tjera. Përveç kësaj, shkencëtarët në Bosnje-Hercegovinë kanë punuar në zhvillimin e teknologjive të ndryshme për t'u marrë me kërcënimin e rreziqeve shpërthyes, duke përfshirë përmes realitetit virtual dhe të shtuar dhe sistemeve të zgjeruara të zbulimit.

Bosnje-Hercegovina po zhvillon aftësitë e saj kombëtare për menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive në konsultim me aleatët, përfshirë zhvillimin e kuadrin ligjor për përbalimin e emergjencave civile dhe punën për krijimin e një sistemi informacioni për krizat civile për të koordinuar aktivitetet në rast emergjence.

Në maj 2014, vendi kërkoi ndihmë nga Qendra Euro-Atlantike e NATO-s për Koordinimin e Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC), pas përmbajtjeve shkatërruese që goditën vendin. NATO koordinoi ndihmën emergjente nga vendet aleate dhe partnere, duke dërguar helikopterë, anije, ujë të pijshëm, ushqim, strehim dhe fonde. Në vitin 2017, vendi priti stërvitjen vjetore të gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive EADRCC që mblodhi së bashku aleatët, partnerët dhe organizatat ndërkombëtare. EADRCC është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin ndaj emergjencave civile në zonën Euro-Atlantike. Ai është aktiv gjatë gjithë vitit, funksionon në baza 24/7 dhe përfshin të gjithë aleatët e NATO-s dhe vendet partnere. Qendra funksionon si një sistem kleringu për koordinimin e kërkesave dhe ofrimit të ndihmës kryesive në rast fatkeqësish natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu.

Bosnje-Hercegovina dhe NATO synojnë të përmirësojnë aksesin e publikut në informacion mbi përfitimet e bashkëpunimit me NATO-n për të gjithë njerëzit që jetojnë në vend dhe për anëtarësimin e mundshëm të vendit në Aleancë. Për këtë qëllim, ekziston një strategji kombëtare e komunikimit e NATO-s. Vëmendje e veçantë i kushtohet aktivitetëve që kërkojnë qëndrueshmëri dhe që lidhin palët kryesore të interesuara: qeveria, shoqëria civile dhe media. Diplomacia publike konsiderohet si një fushë kyçe që ka nevojë për përpjekje dhe burime të përkushtuara për të informuar publikun dhe autoritetet në Bosnje-Hercegovinë për NATO-n. Ekziston nevoja për të siguruar informacion të saktë, për të luftuar dezinformimin dhe për të theksuar përfitimet e përpjekjeve për reforma në Bosnje-Hercegovinë. Selia e NATO-s në Sarajevë siguron burime në terren dhe punon me disa aleatë.

Bosnje-Hercegovina është prekur ndjeshëm nga pandemia COVID-19. Duke demonstruar mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për vendin, në tetor 2020, aleatët miratuan një paketë ndihme për COVID-19, në shumën prej 500 000 eurosh. Kjo paketë asistencë siguroi pajisje mjekësore kritike, duke përfshirë dhomat e presionit, pajisjet me rreze X, termometra me rreze infra të kuqe pa kontakt, maska, veshje mbrojtëse dhe teste antigjene. Në 2021 dhe 2022, mbështetje shtesë u sigurua nga Stoku i Përgjigjes ndaj Pandemisë së NATO-s, i cili përfshinte ventilatorë dhe pajisje mbrojtëse personale. Projektet u zhvilluan bazuar në kërkesën e vendit për ndihmë ndaj Qendrës së Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike të NATO-s (EADRCC).

Të përunjurit e mëdhenj, luftëtarët e paepur në mbrojtje të vegjëlisë

Shën Tereza lindi më 26 gusht 1910.

Migjeni u largua nga kjo botë pikërisht më 26 gusht 1938.

Dy të përunjurit e mëdhenj, luftëtarët e paepur në mbrojtje të vegjëlisë, i lidhte pazgjidhshmërisht zinxhiri mahnitës lindje-vdekje si shkak-pasoje.

Lutjet e Shën Terezës dhe kujat poetike të Migjenit, ishin e njëjta klithmë shpirtrash të mëdhenj nga Shqipëria e vogël drejtuar padrejtësive të botës.

Njëra nga Lindja, tjetri nga Vdekja, Shën Tereza dhe Migjeni vijnë bashkë çdo 26 gusht për të na kujtuar se kudo ku ka dëshpërim dhe dhimbje, ka ngushëllim dhe shpresë.

Shenjtoria Terezë dhe Poeti Migjen na ndezin krenarinë për të mëdhenjtë tanë që ia kemi dhënë edhe botës.

Nga goja e Nënë Terezës dolën aq shumë fjalë të urta, sa do të mund të shkruheshin libra me to! Fjalë fluturake, që ajo vetë nuk kishte kohë t'i shkruante, sepse kohën e shfrytëzonte për t'i dhuruar jetë, atyre që nuk e dinin ç'është jeta.

S'kish kohë për të shkruar libra, e megjithatë la pas aq histori, sa të frymëzojë jo një njeri, po mbarë njerëzimin. E tregojnë fjalët e urta të mëposhtme, që i zgjodhëm si dhuratë për 130 vjetorin e ditëlindjes së Motrës shqiptare të bamirësisë.

Karizmatike dhe e guximshme, Nënë Tereza udhëtoi vazhdimisht për t'i ndihmuar njerëzit që fati, a dora e njeriut, i kish flakur në mes të rrugëve të botës. Njerëz që kërkonin pikërisht një Nënë Terezë për t'i prirë kur bëheshin gati të niseshin nga kjo botë, drejt qiellit, duke i shpëtuar me trup e me shpirt!

E ndërsa vijonte shtegtimin e pafundmë në rrugët e mjerimit, shqiptoi fraza që bëjnë historinë. Thënë shpesh para skenave të tmerrshme, ku gjithkush mund të lemerisej, veç saj! Edhe këto e bëjnë të njohur Nënë Terezën e Kalkutës (1910-1997) në mbarë botën, si misionare e madhe shqiptare, që diti ta vlerësojë dinjitetin e çdo njeriu! Po kujtojmë pakëz prej tyre:

Nënë Tereza për fëmijët

- Fëmijët janë si zogjtë: ju doni t'i mësoni të fluturojnë, por ata nuk do të fluturojnë me flatrat tuaja. Doni t'i mësoni të ëndërrojnë, por ata nuk do të ëndërrojnë ëndrrën tuaj.
- Prindërit duhet të jenë të besueshëm, jo të përsosur. Fëmijët të jenë të lumtur, jo të na bëjnë të lumtur.

- Çfarë mund të bësh për të siguruar paqen botërore? Shko në shtëpi e duaje familjen tënde!
- Disfata më e keqe është humbja e guximit, e mësuesit më të mirë, Fëmijët!

Murgesha shqiptare, për jetën

- E keqja zë rrënjë kur njeriu fillon të mendojë se është më i mirë nga të tjerët.
- Unë mund të bëj gjëra, që ju nuk mundeni; ju mund të bëni gjëra, që unë nuk mundem. Së bashku mund të bëjmë gjëra të mëdha.
- Nuk mund të flasim ndërsa dëgjojmë. Kur të na mbushet zemra, goja do të flasë, mendja do të mendojë.
- E djeshmja nuk është më, e nesërmya nuk ka ardhur ende. Kemi vetëm të sotmen. Le të fillojmë...
- Asnjëherë mos udhëtoni më shpejt sesa mund të fluturojë engjëlli juaj i rojës.
- Një jetë e pa jetuar për të tjerët, nuk është jetë.



DY TË PËRUNJURIT E MËDHENJ, LUFTËTARËT E PAEPUR NË MBROJTJE TË VEGJËLISË, I LIDHTE PAZGJIDHSHMËRISHT ZINXHIRI MAHNITËS LINDJE-VDEKJE SI SHKAK-PASOJË.

LUTJET E SHËN TEREZËS DHE KUJAT POETIKE TË MIGJENIT, ISHIN E NJËJTA KLITHMË SHPIRTRASH TË MËDHENJ NGA SHQIPËRIA E VOGËL DREJTUAR PADREJTËSIVE TË BOTËS.

NJËRA NGA LINDJA, TJETRI NGA VDEKJA, SHËN TEREZA DHE MIGJENI VIJNË BASHKË ÇDO 26 GUSHT PËR TË NA KUJTUAR SE KUDO KU KA DËSHPËRIM DHE DHIMBJE, KA NGUSHËLLIM DHE SHPRESË. SHENJTORJA TEREZË DHE POETI MIGJEN NA NDEZIN KRENARINË PËR TË MËDHENJTË TANË QË IA KEMI DHËNË EDHE BOTËS.

- Mos dhuroni vetëm kujdesin, dhuroni edhe zemrën.
- Gëzimi është shumë ngjites. Kërkoni, pra, të jeni gjithmonë të mbushur me gëzim, kudo që të shkoni.
- Fjalë për dashurinë**
- Sa më pak të kemi, aq më shumë japim. Duket absurde, por kjo është logjika e dashurisë.
- Nëse i gjykon njerëzit, nuk do të kesh kohë t'i duash.
- Duaje jetën, edhe nëse nuk të jep atë që deshe; duaje, edhe nëse nuk është ashtu si e doje! Duaje kur të lindësh e edhe kur të vdesësh.
- Mos dashuro kurrë pa dashuri, e kurrë mos jeto pa jetë!
- Nuk e di si do të jetë parajsja, por e di se kur të vdes dhe të vijë koha që Zoti të më gjykojë, Ai nuk do të më pyesë: "Sa gjëra të

mira bëre në jetën tënde?", por: "Sa dashuri dhurove, në atë që bëre?"

Nënë Tereza erdhi në këtë botë si një bekim për botën, si shpresë për të pambrojturit, si një arsye për të qenë edhe më shumë krenarë që jemi shqiptarë.

Në ditën e lindjes së shenjtore sonë të madhe na vijnë si një mësim për jetën fjalët e saj:

"Jeta është pasuri, vlerësoje."

Jeta është dashuri, jetoje."

Jeta është mister, zbuloje"

Jeta është premim, mbaje!"

86 vjet ndarje nga jeta e Migjenit të madh, por jo nga klithmat therëse të vargjeve poetike të tij. Megjithëse jeta e shkurtër nuk e la të prekë Olimpian e vërtetë të paarrtshëm, ai është në Olimpian modern të letrave shqip! Mbeti edhe pse aq lart ashtu njerëzor Migjeni dhe ndoshta vdekja i bëri "një nder", sepse pikërisht ata që e konsideronin njeri të "idealit" të tyre, mund dhe

ta pushkatonin si "tradhtar idealesh komuniste"! Por Migjeni sigurisht ishte ai që i duhej pikërisht vendit në atë kohë dhe atë cilësi talenti pa caqe të kufizuar rrymash dhe morali të mbytur kohërave! Në fakt ai nuk mungon kurrë në idealizmin e tij modern! Sigurisht modern të një kohe mes diktaturash, luftërash, urie dhe marrëzie, tragjizmi dhe qytetërimi të plagosur politik dhe filozofik! Po, por të një brez idealistësh të fundit, të cilët po përgatiteshin të "krijonin botën e re" dhe një palë me fashizmin dhe tjetra me komunizmin ai influenconte! Ishte një kohë e madhe, ku dhe njerëzit e mëdhenj herë humbnin, herë i persekutonin, herë i çmonin dhe pikërisht kështu ishte dhe bota e asaj periudhe! Gjithmonë në filozofinë e tij, Migjeni na ka frymëzuar dhe mundoheshin atëherë (diktatura) ta bënin të afërt me idealin komunist, kur në fakt ai ishte idealist i qytetërimit, të pa ngjitur te ne, në shoqërinë tonë jo urbane! Kurse unë habitesha dhe frymëzoheha nga "Të lindet njeriu"! Ne bënim gabim se e kuptonin pikërisht atë njeri që kërkonte dhe ëndërronte Migjeni si një "kryenjeri", një mbinjeri dhe dyzimi i kohës mes njeriut-mbinjeriut dhe shoqërisë së "njeriut"! Në të vërtetë ishte gabimi ynë, si shoqëri dhe mentalitetit tonë mesjetar. Ne kërkua plot "mbinjerëz" të tillë. Ata që duhet të ishin pikërisht ëndrra e Migjenit, po gabuam! Ata erdhën me shumicë, por nuk ishin si te, "Të lindet një njeri nga gjin" i dheut tonë të rim me lot të vakët, nga thalbi i shpirtit tonë që shkrihet në dëshirë të flakët për një gen të ri! Nuk ishte fare një "gen i ri" dhe kjo u vërtetua nga të gjithë "mbinjerëzit", Migjeni kërkonte dhe ëndërronte kështu: "Të dali një njeri! Të m'kambi një Kohë të Re! Të krijojë një Epope! Ndër lahuta tona të këndohet Jeta e Re..."

Poetët nuk vdesin



Nga Sakip Cami

Ubënë disa vite që Simon Kaca nuk jeton më. Nuk jeton fizikisht, por ai jeton në jetë të jetëve sepse poetët nuk vdesin, pasi kanë lënë pas poezinë e shpirtit të tyre. E kisha një peng për ta bërë këtë shkrim që në gjallje të tij, kur ma dhuroi me nënshkrimin e tij, me shkrimin e tij me kaligrafi të bukur, librin e tij poetik “Në sy fjalën ta lexoj”.

Siç e shikoni në këtë foto, me Simonin kemi qenë kolegë, kur shërbenim si ushtarakë në qytetin e Bulqizës. Në këtë foto është edhe Islam Cenga, një poet tjetër, mësues letërsie në gjimnazin e këtij qyteti. Shkruanim në gazetën “Luftëtari”, “Ushtima e Maleve”, “Ushtria”, shkruanim dhe botonim poezi në organet letrare.

Së bashku me Hajri Mandrin, në atë kohë drejtor i Kinoklubit të Bulqizës, Demir Rusin, shefin e shtëpisë së ushtarakëve, Halil Ramën, metodistin e shtëpisë së ushtarakëve, Pllumb Dervishin, metodistin e Kinoklubit




të qytetit, kompozitorin Xhelil Ymeri, piktorin dhe muzikantin Azem Teta e shumë të tjerë, kontribuonim për mbajtjen gjallë të jetës kulturore të këtij qyteti minator.

Shumë nga poezitë e atyre viteve janë përmbledhur edhe në vëllimin e tij poetik që e

ka përgatitur për botim, një tjetër poet i shquar i Ushtrisë dhe i Shqipërisë, Arben Duka. Ja si shkruan Arben Duka në parathënien e librit: “Poezitë e këtij vëllimi janë shkruar për vite me radhë dhe të krijojnë një gjendje të këndshme shpirtërore kur i lexon. Simon Kaca të fut natyrshëm në botën e tij intime dhe mund të themi se libri në fjalë është personalizimi i vetvetes. Në poezitë e Simonit përdoren me mençuri dhe masë figurat letrare, me synimin për të mos i ndërlikuar ato e për të mos i bërë të padeshifrueshme si një kriptogram.”

Simonit është nga Ulza, qyteza buzë liqenit që mban emrin e saj. Ai shkruan për të: “Ulza !... Muza ime poetike që nuk shteron kurrë... Nuk shteron me Shkopetin si një djep që përkundet, me Bushkashin si bletë mbi nektarin e një lulefushe, me Stojanin si kurorë si mbi ballin e një nuseje, me Sanxhakun qerpikvajze mbi “syrin” e liqenit, me Lundrenë si flutur mbi krahët e një pishe, me Madheshin si një pikë



loti në fytyrën e një fëmije, me Kokërdhokun si flokë dëbore mbi një tufë kaçurrela e me sa e sa puhiza drite që vrullojnë nëpër zemra...

Vendlindja ime e shtrenjtë më rriti, u bëra oficer i Ushtrisë Shqiptare, më bëri poet, u riktheva si drejtues i saj për të punuar së bashku dhe këtë libër ja kushtoj Ulzës.”

Nuk do të ndalem të bëj analizën e poezisë së Simon Kacës, por do të citoj një poezi të tij, duke ia lënë lexuesit vlerësimin, por duke menduar se humbën një poet, një njeri të mrekullueshëm, një drejtues model në shërbim të komunitetit.

*“Shko, poezia ime
Te shtëpi e vjetër
Dhe këpute një degë malli*

*Shko, poezia ime
Tek Liqen’ i Ulzës
Dhe merre një gur zalli*


*Shko, poezia ime
Tek flokët e thinjura të nënës
E puthe për mua*

*Shko, poezia ime
Tek zemra që pret
E thuaji: ‘Të dua!’”*

Kush është Simon Kaca?

Simon Kaca është lindur në vitin 1960 në fshatin Bushkash afër Liqenit të Ulzës. Shkollën 8-vjeçare dhe të mesme e kreu në qytetin e Burrelit. Më pas kreu studimet në Shkollën e Lartë të Oficerëve Tiranë, ku u titullua oficer. Shërbeu në repartet e Bulqizës dhe të Burrelit. Pas lirimit nga ushtria, në vitin 1992, shërben si mësues në Ulzë dhe më pas zgjidhet dy herë kryetar komune në Ulzë.

U nda nga jeta në vitin 2007, duke lënë pas krijimtarinë e tij poetike dhe veprimtarinë e devotshme në shërbim të komunitetit.



Jo çdo shpikje ushtarake është aq e dobishme

Lufta psikologjike është një aspekt i madh i luftës. Nëse armiku mendon se ju keni epërsi, ata do ta kenë të vështirë ta kapërcejnë atë handicap të vetë-imponuar dhe të luftojnë kundër. Më pak gjëra e vendosin frikën në zemrat e trupave më shumë sesa të mendosh se po përballen me një teknologji të re që nuk mund t'i kundërvihet. Zakonisht, fuqia shkatërruese e këtyre pajisjeve është po aq e dukshme sa një e shtënë me armë, por ndonjëherë, një ushtri në vend të kësaj qëllon bosh.

Pothuajse çdo pjesë e teknologjisë ushtarake është krijuar për të përmirësuar efikasitetin luftarak. Ndonjëherë është një armë që gjuan nëpër qoshe pa ekspozuar mbajtësin, herë të tjera është një automjet që lëshon lazer të vërtetë. Armët si këto ndryshojnë mënyrën se si zhvillohen luftërat, por jo çdo shpikje ushtarake është aq e dobishme, ose e aq përdorshme. Për shembull, ushtria amerikane u përpoq të krijonte një model kamuflazhi që mund t'i lejonte ushtarët të përziheshin në çdo mjedis. Në pamje të parë kamuflazhi universal tingëllon si një shpikje e pabesueshme që do të ishte e mundur vetëm në videolojëra, por kur ushtria e provoi, doli që kundërshtarët kishin të drejtë. Nuk funksionoi.

Por modeli universal i kamuflazhit ishte larg nga shpikja e vetme ushtarake që nuk mund të përballonte zhurmën - ka shumë shembuj të tjerë.



Raketat hipersonike

Raketat janë disa nga armët më të rrezikshme në planet. Jo vetëm që mund të mbajnë ngarkesa shkatërruese, por janë gjithashtu të afta të ndryshojnë trajektorën. Shumë vende kanë sisteme të mbrojtjes kundër raketave, por teatri i luftës ka të bëjë me përshkallëzimin.

Disa vite më parë, presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se vendi i tij po zhvillonte raketa hipersonike. Një nga raketat supersonike më të shpejta në botë është BRAHMOS, e cila ka një shpejtësi maksimale pak më pak se 3 Mach, por hipersonikët e Rusisë do të jenë në gjendje të eklipsojnë 20 Mach. Irani po zhvillon gjithashtu raketën e tij hipersonike. Pse është diçka e madhe? Në vend të mbajtjes së masave mbrojtëse kundër raketave, hipersonikët thjesht mund të kapërcejnë municionet në hyrje. Është një zgjidhje sa e thjeshtë aq edhe e rrezikshme, por vetëm nëse funksionon.

Sipas inxhinierëve dhe fizikanëve si David Wright dhe Cameron Tracy, pengesat më të mëdha me të cilat do të përballen raketat hipersonike nuk do të jenë shpërthimet EMP ose raketa të tjera, por fizika e përgjithshme. Sa më shpejt që një objekt lëviz nëpër një lëng, aq më shumë rezistencë përballlet. Kjo rezistencë, e njohur si zvarritje, e kthen energjinë kinetike në valë goditëse dhe energji termike. Raketat hipersonike potencialisht mund të udhëtojnë aq shpejt sa që tërheqja e tyre do të kërcënonte integritetin e tyre. Edhe nëse zvarritja nuk i shkund raketat hipersonike, ato nuk do të jenë veçanërisht të shkathëta për shkak të shpejtësive të tyre intensive.

Kështu, raketat hipersonike mund të mos jenë e ardhmja e luftës për të cilën u përfolën.

Modeli universal i kamuflazhit

Thënia e Muhamed Aliut "Duart nuk mund të godasin atë që sytë nuk mund ta shohin" vlen për më shumë sesa thjesht boksing. Kamuflimi është një mjet thelbësor në çdo fushë beteje, sepse trupat e armikut nuk mund t'ju godasin me plumba nëse nuk e dinë se ku jeni. Megjithatë, si në mbretërinë e kafshëve, kamuflimi



duhet të dizajnohet duke pasur parasysh një mjedis specifik.

Ushtria amerikane ka punuar për kamuflimin që nga shekulli i 19-të dhe me avancimin e teknologjisë, dizajnerët kanë përdorur kompjuterë për të krijuar dizajne të bazuara në piksel, pasi ato ngatërrojnë trurin. Trupat e Marinës e përdorën shumë këtë teknikë dhe ushtria amerikane donte të hynte në këtë ide, por ata gjithashtu donin që kamuflimet e tyre të ishin më ekonomike dhe të aftë për t'u përzier në sa më shumë mjedise. Zgjidhja e ushtrisë ishte një model maskimi universal. Teorikisht, njollat me piksele të dizajnit me gri, bezhë dhe jeshile do të maskonin ushtarët në mjedise pyjore, shkretëtirë dhe urbane. Në praktikë, modeli rezultoi mjaft vdekjeprurës për mbajtësit e tyre.

Për shkak të mënyrës se si ishin vendosur pikselat e Modelit Universal të Kamuflazhit dhe për shkak se dizajnit i mungonte ngjyra e zezë, ai prodhoi atë që njihet si izolim. Ky iluzion optik e bën trurin e njeriut të shohë shumë ngjyra dhe modele si një pikë e fortë. Si rezultat, Modeli Universal i Kamuflazhit bëri që këdo që e mbante të dukej 2D kur shihej kundër sipërfaqeve 3D.

Modeli Universal i Kamuflazhit bëri të kundërtën e kamuflimit të përdoruesve të tij, gjë që nuk është një rezultat ideal kur vihen në lojë jetët e njerëzve.

Çfarë po përdor Rusia kundër Ukrainës

Propaganda mund të jetë një mjet i fuqishëm. Nëse i kushtoni vëmendje lajmeve, me siguri keni parë mjaft raporte mbi propagandën ruse anti-ukrainase shumë intensive. Media shtetërore ruse ka pretenduar se po pushton Ukrainën për të "denazifikuar" vendin dhe se shumë ukrainas janë mirënjohës për këtë shkelje të kufijve të tyre. Për më tepër, shumë fushata reklamash ruse tregojnë ushtrinë e saj në një pozicion pushteti me të gjitha armët dhe parzmoret më të mira, që është një nga gënjeshttrat më të mëdha.

